



RAPORT MBI ANKETIMIN STUDENTOR 2025-2026 (SEM. I)

**UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË
CILESIA@UPT.AL**

HYRJE

Bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë, Standardet dhe Kriteret e përcaktuara në Kodin e Cilësisë, Universiteti Politeknik i Tiranës është përgjegjës për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë.

Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (DSBC) organizon pyetësin studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi.

Ky pyetësor organizohet në fund të çdo semestri për të gjitha fakultetet.

DSBC ka organizuar pyetësin studentor nga viti akademik 2017-2018, semestri i dytë e në vazhdim dhe ka hartuar raportet përkatëse të cilat gjenden të publikuara në faqen zyrtare të UPT.

<https://upt.edu.al/drejtimi-akademik-administrativ/drejtorite/drejtoria-e-sigurimit-te-brendshem-te-cilesise/>

Më poshtë pasqyrohen në mënyrë të detajuar të gjithë hapat e ndjekur për realizimin e procesit të anketimit, deri në gjenerimin e rezultateve dhe hartimin e rekomandimeve.

Për 6 Fakultete, pyetësi është realizuar përmes sistemit “Bit-Albania” dhe është administruar nga DSBC, kurse për Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike, pyetësi është zhvilluar përmes sistemit “Pitagora” dhe është administruar nga FIM.

Duke qënë se janë përdorur të njëjtat pyetje/pohime dhe metodologjia e zhvillimit dhe mbledhjes së të dhënave të pyetësorëve ka qënë e njëjtë (si për fakultetet që kanë sistemin e sekretarisë “Bit-Albania” ashtu edhe për fakultetin që ka sistemin “Pitagora”), rezultatet e këtij pyetësi për të 7 fakultetet janë përpunuar dhe trajtuar nga DSBC duke ndjekur të njëjtën metodologji.

PËRMBAJTJE

HYRJE	0
1. BAZA LIGJORE	3
1.1. LIGJI I ARSIMIT TË LARTË	3
1.2. KODI I CILËSISË SË ARSIMIT TË LARTË	3
1.3. STATUTI I UNIVERSITETI POLITEKNIK TË TIRANËS	3
2. ORGANIZIMI I PYETËSORIT	3
2.1. QËLLIMI I PYETËSORIT	3
2.2. HARTIMI I PYETJEVE DHE KRITERET E VLERËSIMIT	3
3. SISTEMI ELEKTRONIK I PYETËSORIT	4
3.1. GJENERIMI I TË DHËNAVE	5
4. METODOLOGJIA E PYETËSORIT	5
5. REZULTATET E ANKETIMIT	6
5.1. PJSËMARRJA NË ANKETIM	6
5.2. EVIDENTIMI I PROBLEMATIKAVE NË NIVEL INSTITUCIONI	7
6. REZULTATET SIPAS FAKULTETEVE DHE PROGRAMEVE TË STUDIMIT	9
6.1. FAKULTETET PJSË E ANKETIMIT	9
6.2. PROGRAMET E STUDIMIT PJSË E ANKETIMIT	9
6.3. REZULTATET PËR ÇDO FAKULTET/PROGRAM STUDIMI	10
7. ANALIZA DHE REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIMIN E TREGUESVE TË ULËT	18
7.1. REKOMANDIME	22
8. VLERËSIMET E PEDAGOGËVE	23
8.1. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME	23
8.2. IDENTIFIKIMI I VLERËSIMEVE TË ULËTA	24
8.3. REKOMANDIMET DHE PROPOZIMET PËR PËRMIRËSIMIN E TREGUESVE TË ULËT	24
9. ANEKSE TË PYETËSORIT	25
9.1. RANKIMET E FAKULTETEVE / PROGRAMEVE TË STUDIMIT	25
9.2. RANKIMI I PEDAGOGËVE (TË DHËNA KONFIDENCIALE)	25

1. Baza Ligjore

1.1. Ligji i Arsimit të Lartë

Procesi i Anketimit të studentëve është një proces i parashikuar në Ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor”:

Kreu X “SIGURIMI I CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË”, Neni 103 “Sigurimi i brendshëm i cilësisë”, pika 1,2,3.

1.2. Kodi i Cilësisë së Arsimit të Lartë

Ky raport i referohet edhe standardeve dhe kriterëve për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, të përcaktuara në **VKM Nr.824, datë 24.12.2021 “Për Miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”**, si përmbledhje e standardeve shtetërore për sigurimin e cilësisë në të gjitha ciklet e programeve të studimit që ofron UPT:

SHTOJCA NR. 1, STANDARDET PËR SIGURIMIN E CILËSISË PËR INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË, III. PROGRAMET E STUDIMIT, MËSIMDHËNIA DHE VLERËSIMI, Standardi III.15 “Programet zhvillohen me qëllim përfshirjen aktive të studentëve në përfitim të kompetencave”, Kriteri 4. “Institucioni mbledh në mënyrë të vazhdueshme mendimin e studentëve nëpërmjet pyetësorëve për cilësinë e mësimdhënies dhe ndërmerr procedura me qëllim përmirësimin.”

1.3. Statuti i Universiteti Politeknik të Tiranës

Statuti i UPT, parashikon aktivitetin e DSBC mbi procesin e anketimeve studentore sipas Nenit 79 “Njësia Qëndrore e Sigurimit të Cilësisë” pika 5/e.

2. Organizimi i pyetësorit

Me Urdhër të Rektorit **Nr.01, Datë 05.01.2026**, të gjitha sekretaritë mësimore përditësuan të dhënat mbi pedagogët në Sistemin Elektronik.

Plotësimi u zhvillua në datat **13 – 22 Janar 2026**, nëpërmjet platformës online të sekretarisë mësimore: <http://bit-albania.com/upt.php> dhe <https://upt.pitagora.rash.al/>.

Për të garantuar pjesëmarrje dhe njohjen sa më të mirë me procesin, studentët u informuan përmes e-mail-it në lidhje me kohën e kryerjes së anketimit, mënyrën e plotësimit dhe rëndësinë e këtij procesi.

Nëpërmjet këtij pyetësori, çdo studenti ju dha mundësia të shprehë perceptimin e tij mbi procesin mësimor dhe personelin akademik si dhe të përcjellë pranë autoriteteve të Universitetit shqetësime specifike. Plotësimi i pyetësorit bëhet për çdo lëndë dhe çdo pedagog që merr pjesë në mësimdhënie në semestrin aktual.

2.1. Qëllimi i Pyetësorit

Ky pyetësor ndihmon në krijimin e një panorame të problematikave në UPT, duke u fokusuar tek perceptimi i studentëve në lidhje me universitetin, fakultetin, programin e studimit ku ata studiojnë dhe pedagogët e tyre, për të mundësuar përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë akademike duke vazhduar traditën e ekselencës e duke konsoliduar reputacionin kombëtar e rajonal.

2.2. Hartimi i pyetjeve dhe Kriteret e vlerësimit

Për të përmbushur qëllimin e këtij pyetësori, u mendua që pyetjet të jenë të thjeshta për t'u kuptuar. Bazuar në eksperiencën të ngjashme si dhe në konsultime me stafin e UPT, u arrit në hartimin e 9 pyetjeve:

- (P1) Informon në fillim të semestrit për përmbajtjen, objektivat dhe detyrimet e programit mësimor
- (P2) Respekton vazhdimisht dhe me përpikmëri orarin mësimor
- (P3) Është lehtësisht i kuptueshëm gjatë referimit / komunikimit në procesin mësimor
- (P4) Sqaron aspektet teorike me shembuj praktike dhe/ose ilustrime të qarta
- (P5) Përdor në mënyrë efikase mjete ndihmëse në procesin mësimor (dërrasën e zezë, video projektorin, etj.), sipas specifikës dhe natyrës së lëndës.
- (P6) Rekomandon literaturë ndihmëse në lidhje me procesin mësimor
- (P7) Komunikon dhe sillet brenda kuadrit etik
- (P8) Është i gatshëm të ndihmojë studentët edhe përtej orës së mësimimit
- (P9) Nxit interesin dhe motivon studentët në lëndën përkatëse
- (Nota) E vlerësoj me NOTEN:
- (Komenti)

Studenti ka të drejtën e vlerësimit të çdo pedagogu me pikë nga 1 deri në 5 për nëntë pyetjet e para, ku:

1 - është vlerësimi më i ulët

5 - është vlerësimi më i lartë


Për një vlerësim më të përgjithshëm studenti vendos edhe notë me vlerën nga 1-10.

Në fund, sipas dëshirës, studenti mund të japë edhe një vlerësim nëpërmjet një komenti me shkrim për pedagogun e lëndës.

3. Sistemi elektronik i pyetësorit

Për të krijuar një ide sa më të qartë të funksionimit të sistemit, hapat e ndjekur për plotësimin e pyetësorit, paraqiten në vijim:

1. Hyjmë në faqen zyrtare të sekretarisë mësimore: <http://bit-albania.com/upt.php>.
2. Zgjedhim Universiteti Politeknik i Tiranës.
3. Zgjedhim Fakultetin ku studiojmë.
4. Me hyrjen në portal, zgjedhim opsionin **“Anketim për Pedagogët”**.
5. Ndiqen instruksionet e nevojshme për plotësimin e pyetësorit.
6. Pasi të plotësohet pyetësori, shtypim butonin **“Prano të Gjitha Vlerësimet e Mëposhtme”**.
7. Në qoftë se në ekran shfaqet mesazhi **“KUJDES, nuk ju përgjigjët të gjitha pyetjeve”**, atëherë duhet të kthehemi mbrapsht për të plotësuar të gjitha pyetjet.
8. Në qoftë se në ekran shfaqet mesazhi **“Vlerësimet tuaja u memorizuan. Faleminderit për kontributin”**, atëherë pyetësori është plotësuar me sukses.



3.1. Gjenerimi i të dhënave

Pas përfundimit të anketimit, të dhënat e përfuara gjenden të koduara (enkriptuara) format Excel, me këto informacione kryesore:

Ida	Fakulteti	Pedagogu	StMD5p2	Grupi	P1	P2	P3	P4	P5	P6	P7	P8	P9	Nota	Koment	Lenda
1782	XXX	XXX XXX	f5e27071836548cba4cbcd42e6badf84	XXXXXXXX	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	XXX XXX
17106	XXX	XXX XXX	adc0fc1a9ebeec89a3d5b43e20198dcd	XXXXXXXX	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	XXX XXX
17107	XXX	XXX XXX	adc0fc1a9ebeec89a3d5b43e20198dcd	XXXXXXXX	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	XXX XXX

Gjenerimi i të dhënave është i njëjtë, si për fakultetet që kanë përdorur sekretarinë mësimore “Bit-Albania”, ashtu edhe për fakultetin që ka përdorur sekretarinë mësimore “Pitagora”.

Përgjigjet e pyetësorit gjenerohen dhe përpunohen në mënyrë **ANONIME** nga UPT dhe mbi bazën e tyre janë hartuar të dhëna statistikore për të evidentuar problematikat kryesore të perceptuara nga studentët. Në çdo rast, analiza e të dhënave të pyetësorit përcillet në fakultete pas përmbylljes së sesionit të provimeve, duke shmangur kështu çdo ndikim të mundshëm në vlerësimet përfundimtare.

4. Metodologjia e pyetësorit

Mbi bazën e të dhënave të gjeneruara nga sistemet (“Bit-Albania” dhe “Pitagora”), u realizua një analizë statistikore në disa nivele:

- Nivel Institucioni
- Nivel Fakulteti
- Nivel Programesh Studimi
- Nivel Pedagogu

Në këtë mënyrë, u llogarit për të gjitha nivelet e analizës mesatarja aritmetike për çdo pyetje nga **P1** deri në **P9**, mesatarja aritmetike për vlerësimin me notë dhe sipas Formulës së Rankimit. Gjithashtu, për rezultatet në nivel Institucioni është llogaritur edhe moda dhe mediana, si tregues më të avancuar të trendit të përgjigjeve.

Formula e Rankimit është një instrument vlerësimi kompleks ku komponentë të ndryshëm kanë peshë të ndryshme në raport me vlerësimin e përgjithshëm të cilësisë. Gjithsesi, studenti bën një vlerësim me notë dhe vihet re që formula e propozuar dhe vlerësimi i përgjithshëm i studentit nuk kanë shmangie domethënëse.

Vlerësimi sipas formulës së rankimit është një vlerësim që del si rezultat i mesatares së ponderuar të 9 pyetjeve, ku secila nga këto të fundit shumëzohet me një koeficient që i referohet peshës së pyetjes në formulë.

- **(P1)** Informon në fillim të semestrit për përmbajtjen, objektivat dhe detyrimet e programit mësimor (X 5%)
- **(P2)** Respekton vazhdimisht dhe me përpikmëri orarin mësimor (X 20%)
- **(P3)** Është lehtësisht i kuptueshëm gjatë referimit / komunikimit në procesin mësimor (X 20%)
- **(P4)** Sqaron aspektet teorike me shembuj praktike dhe/ose ilustrime të qarta (X 5%)
- **(P5)** Përdor në mënyrë efektive mjete ndihmëse në procesin mësimor (dërrasën e zezë, video projektorin, etj.), sipas specifikës dhe natyrës së lëndës. (X 10%)
- **(P6)** Rekomandon literaturë ndihmëse në lidhje me procesin mësimor (X 10%)
- **(P7)** Komunikon dhe silltet brenda kuadrit etik (X 15%)
- **(P8)** Është i gatshëm të ndihmojë studentët edhe përtej orës së mësimi (X 5%)
- **(P9)** Nxit interesin dhe motivon studentët në lëndën përkatëse (X 10%)

Formula e Rankimit :

Vlerësimi= $P1 \times 5\% + P2 \times 20\% + P3 \times 20\% + P4 \times 5\% + P5 \times 10\% + P6 \times 10\% + P7 \times 15\% + P8 \times 5\% + P9 \times 10\%$

5. Rezultatet e anketimit

5.1. Pjesëmarrja në Anketim

Pas përpunimit të të dhënave për të 7 Fakultetet, numri i anketimeve është **15544 ANKETIME**, të shpërndara sipas Fakulteteve përkatëse.

Sipas rregullave të anketimit, një student plotëson anketimin për lëndët që frekuenton si student i rregullt në këtë semestër. Studentët përsëritës nuk janë pjesë e anketimit, pasi ata kanë të drejtën e shprehjes nëpërmjet anketimit vetëm një herë, në momentin që e ndjekin lëndën për herë të parë.


Numri i studentëve pjesëmarrës në anketim për të gjitha Fakultetet është: **2128 STUDENTË**.

NR.	FAKULTETI	NR I ANKETIMEVE	NR I STUDENTËVE PJESËMARRËS	*NR I STUDENTËVE/FAKULTET	% E STUDENTËVE PJESËMARRËS
1	Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës	2321	309	735	42.0%
2	Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave	614	100	311	32.2%
3	Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike	2207	268	719	37.3%
4	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike	2228	329	851	38.7%
5	Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike	522	106	136	77.9%
6	Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit	3848	490	1257	39.0%
7	Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit	3804	526	1335	39.4%
	TOTALI	15544	2128	5344	39.8%

**Duhet të theksojmë faktin se numri total i studentëve për secilin fakultet i referohet numrit të studentëve të rregullt të raportuar nga sekretaritet mësimore në Janar 2026.*

5.2. Evidentimi i problematikave në nivel Institucioni

Nga përpunimi i të dhënave në rang Institucioni është bërë një përmbledhje e vlerësimeve mesatare për secilën nga pyetjet si dhe për vlerësimet me notë (grafiku i mësipërm). Gjithashtu, është bërë dhe analiza e vlerave të modës dhe medianës për të krijuar një ide më specifike mbi trendin e vlerësimit.



Bazuar në analizën e rezultateve të pyetësorit të zhvilluar me studentët, janë identifikuar tre fusha që kërkojnë vëmendje të shtuar:

P3 Është lehtësisht i kuptueshëm gjatë referimit / komunikimit në procesin mësimor: **4.642**

P6: Rekomandon literaturë ndihmëse në lidhje me procesin mësimor: **4.635**

P8: Është i gatshëm të ndihmojë studentët edhe përtej orës së mësimi: **4.642**

P9: Nxit interesin dhe motivon studentët në lëndën përkatëse: **4.640**

P3 Duke qenë se lëndët e inxhinierisë karakterizohen nga një nivel i lartë kompleksiteti teknik, qartësia në komunikim paraqet një sfidë të shtuar dhe kërkon qasje tjetër në mësimdhënie. Për të përmirësuar këtë aspekt, DSBC rekomandon:

- Të përdoren shembuj praktikë dhe aplikime reale për shpjegimin e koncepteve bazë.
- Përdorimi i një gjuhe të thjeshtë gjatë mësimdhënies, e shoqëruar me skema, diagrama dhe simulime për të lehtësuar kuptimin.
- Të organizohen orë (sesione) shtesë praktike për temat më të rëndësishme.

- P6** Një nga pikat e identifikuara me vlerësim më të ulët në sondazhin studentor është treguesi që lidhet me rekomandimin e literaturës ndihmëse gjatë procesit mësimor. Ky rezultat tregon nevojën për rritjen e mbështetjes akademike për studentët përmes ofrimit të burimeve shtesë. Për të përmirësuar këtë aspekt shumë të rëndësishëm, DSBC rekomandon:
- Pedagogët të përgatisin lista të literaturës ndihmëse për çdo lëndë, të përditësuara për çdo vit akademik.
 - Të përditësohet literatura në sylabuset e lëndëve nga grupet mësimore në departament.
 - Të promovohen burimet e literaturës fizike dhe online që ofron biblioteka shkencore dhe burime të tjera që disponon fakulteti.
- P8** Mbështetja që pedagogët u ofrojnë studentëve përtej orës së mësimi është thelbësore për një proces mësimor cilësor dhe gjithëpërfshirës. Ky aspekt rrit motivimin dhe krijon një lidhje më të fortë akademike mes studentit dhe pedagogut. Rezultatet e sondazhit evidentuan se ky tregues është ndër më të ulët në rang universiteti. Për të përmirësuar këtë indikator, DSBC rekomandon:
- Vendosja e orëve fikse të konsultimeve javore nga çdo pedagog, të afishuara dhe të aksesueshme për studentët.
 - Përdorimi i mjeteve digjitale (email institucional, forume online, platformë elektronike) për komunikim jashtë orarit mësimor.
 - Krijimi i programeve të mentorimit akademik, ku pedagogët ofrojnë mbështetje për studentët me vështirësi të veçanta.
- P9** Nxitja e interesit dhe motivimi i studentëve përbën një nga elementët kryesorë të cilësisë së mësimdhënies. Ky aspekt ndikon drejtpërdrejt në përfshirjen aktive të studentëve dhe në rezultatet e tyre akademike. Sondazhi evidentoi se ky tregues ka marrë vlerësimin më të ulët, duke sinjalizuar nevojën për strategji më efektive nga pedagogët për të bërë mësimdhënien më tërheqëse dhe të lidhur me praktikën bashkëkohore. Disa rekomandime që mund të ndikojnë pozitivisht në motivimin dhe nxitjen e studentëve janë:
- Të krijohen mundësi për pjesëmarrje aktive në mësim përmes projekteve dhe punës praktike.
 - Të inkurajohet përdorimi i metodave të mësimdhënies interaktive (debate, diskutime, studime rasti).
 - Të përfshihen aplikime të drejtpërdrejta të lëndës në situata reale, si dhe krijimi i mundësive për studentët që të shprehin mendimet dhe pyetjet e tyre.
 - Mbështetja psikologjike dhe orientimi profesional ku përfshihet edhe këshillimi akademik apo motivimi personal, janë shumë të vlefshme, sidomos në vitet e para të studimit.

6. Rezultatet sipas Fakulteteve dhe Programeve të Studimit

6.1. Fakultetet pjesë e anketimit

Fakultetet pjesëmarrëse në anketim janë

1. Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës
2. Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit
3. Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike
4. Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave
5. Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit
6. Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike
7. Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike

Vlen të theksohet fakti që edhe pse janë përdorur dy sisteme sekretarie të ndryshme (Bit-Albania, administruar nga DSBC dhe "Pitagora" për fakultetin e Inxhinierisë Mekanike, administruar nga FIM), metodologjia e ekstraktimit të të dhënave, ruajtjes së anonimatit, pyetjeve/pohimeve të përdorura dhe dorëzimit të tyre ka qënë e ngjashme.

Për rrjedhojë rezultatet e përfuara janë trajtuar njësoj gjatë gjithë këtij raporti, në të gjitha nivelet e përmendura në pikën 4 të tij.

6.2. Programet e Studimit pjesë e anketimit

Nga analiza e të dhënave paraprake, janë evidentuar 60 Programe Studimi të cilat kanë qënë pjesë e këtij anketimi.

Për të përcaktuar numrin e anketimeve të cilat nuk përbëjnë statistikë, duhet marrë në konsideratë që një Program Studimi duhet të ketë një numër minimal studentësh pjesëmarrës, atëherë rezultatet e vjela do të quhen të vlefshme në ato Programe Studimi të cilat kanë një numër anketimesh më të madh se **50**.

Nga sa më lart, rezultatet në vijim të këtij raporti nuk përfshijnë 23 Programe Studimi të cilat kanë më pak se 50 anketime.

NR.	FAKULTETI	PROGRAMI I STUDIMIT (NËN 50 ANKETIME)	NR. I ANKETIMEVE
1	FGJM	Bachelor në "Inxhinieri e Burimeve Minerare"	31
2		Bachelor në "Inxhinieri Gjeologjike"	35
3		Bachelor në "Inxhinieri Gjeomjedisit"	11
4		Master i Shkencave në "Inxhinieri e Burimeve Minerare" me profil "Inxhinieri Minerare dhe Markshajderi"	17
5		Master i Shkencave në "Inxhinieri e Gjeomjedisit"	15
6		Master i Shkencave në "Inxhinieri e Naftës dhe Gazit"	7
7		Master profesional në "Inxhinieri Gjeologjike" me profil "Gjeoinformatikë"	7
8		Master Profesional në "Inxhinieri Gjeologjike" me profil "Gjeologji Inxhinierike dhe Hidrogjeologji"	7
1	FIE	Master i Shkencave në "Inxhinieri Elektrike" me profil "Automatizimi i Industrisë"	7
2		Master i Shkencave në "Inxhinieri Elektrike" me profil "Energjetikë"	41
3		Master i Shkencave në "Inxhinieri Mekanike"	17
4		Master profesional në "Inxhinieri Mekanike"	22
5		Master Profesional në "Elektroenergjitikë"	43
1	FIMF	Bachelor në "Inxhinieri Matematike dhe Data Science"	24
2		Master i Shkencave në "Inxhinieri Matematike dhe Aktuaristikë"	4
3		Master Profesional në "Inxhinieri Matematike në Analiza Sistemesh"	15
1	FIN	Master i Shkencave në "Inxhinieri Ndërtimi" me profil "Gjeoteknikë"	6
1	FTI	Bachelor në "Inxhinieri të sistemeve Elektronike"	45
1	FIM	Bachelor në "Inxhinieri Materiale"	49
2		Master i Shkencave në "Inxhinieri Tekstili dhe Mode"	15
3		Master i Shkencave në "Inxhinieri Ekonomike"	32
4		Master i Shkencave në "Inxhinieri Materiale", profili "Materiale"	10
5		Master i Shkencave në "Inxhinieri Mekanike", profili "Energjitikë" Diplome e dyfishtë	9

Tabela në vijim jep programet e studimit të cilat kanë **më shumë se 50 anketime**. Për këto programe është kryer një analizë më e detajuar në vijim të raportit.


NR.	FAKULTETI	PROGRAMI I STUDIMIT (MBI 50 ANKETIME)	NR. I ANKETIMEVE
1	FAU	Bachelor në "Arkitekturë Interieri dhe Dizajn"	370
2		Master i Shkencave në "Arkitekturë" me profil "Arkitekt"	1224
3		Master i Shkencave në "Arkitekturë" me profil "Urbanist"	727
1	FGJM	Bachelor në "Inxhinieri e Naftës dhe Gazit"	107
2		Bachelor në "Inxhinieri Gjeoinformatike"	119
3		Master i Shkencave në "Inxhinieri Gjeologjike" me profil "Gjeoinformatikë"	77
4		Master i Shkencave në "Inxhinieri Gjeologjike" me profil "Gjeologji Inxhinierike dhe Hidrogjeologji"	56
5		Master Profesional në "Inxhinierinë e Burimeve Minerare" me profil "Gjeomatikë"	125
1	FIE	Bachelor në "Inxhinieri Elektrike", me profil "Energjitikë"	1100
2		Bachelor në "Inxhinieri Mekatronike"	519
3		Master profesional në "Inxhinieri Elektrike" me profil "Automatizim Industrie"	458
1	FIMF	Bachelor në "Inxhinieri Kimike"	115
2		Bachelor në "Inxhinierinë Fizike"	50
3		Bachelor në "Inxhinierinë Matematike"	55
4		Master i Shkencave në "Inxhinieri Fizike" me profil "Inxhinier Fizike"	99
5		Master i Shkencave në "Inxhinieri Fizike" me profile "Fizikan Mjekësor"	107
6		Master i Shkencave në "Inxhinieri Matematike"	53
1	FIN	Bachelor në "Inxhinieri Gjeodet"	427
2		Bachelor në "Inxhinieri Mjedisi"	375
3		Bachelor në "Inxhinieri Ndërtimi"	1687
4		Bachelor në "Inxhinierinë Hidroteknike"	705
5		Master i Shkencave në "Inxhinieri Gjeodezi"	63
6		Master i Shkencave në "Inxhinieri Hidrotenikë"	79
7		Master i Shkencave në "Inxhinieri Mjedisi" me profil "Trajtim Uji"	217
8		Master i Shkencave në "Inxhinieri Ndërtimi" me profil "Infrastrukturë e Transportit"	70
9		Master i Shkencave në "Inxhinieri Ndërtimi" me profil "Strukturist"	219
1	FTI	Bachelor në "Inxhinieri Elektronike"	1097
2		Bachelor në "Inxhinieri Informatike"	1359
3		Bachelor në "Inxhinieri Kompjuterike"	56
4		Bachelor në "Inxhinieri të Telekomunikacioneve"	1023
5		Master i Shkencave në "Inteligjencë Artificiale dhe Optimizim"	91
6		Master i Shkencave në "Inxhinieri Informatike"	63
7		Master i Shkencave në "Inxhinieri Telekomunikacioni"	70
1	FIM	Bachelor në "Inxhinieri Ekonomike"	561
2		Bachelor në "Inxhinieri Mekanike"	1301
3		Bachelor në "Inxhinieri Tekstili e Mode"	117
4		Master i Shkencave në "Inxhinieri Mekanike"	134

6.3. Rezultatet për çdo Fakultet/Program Studimi

Më poshtë janë paraqitur vlerësimet e përfuara nga anketimi në nivel fakultetit dhe në nivel programesh studimi. Si për fakultetet ashtu edhe për programet e studimit janë identifikuar dy (ose me shumë) pohime me rezultat më të ulët.

● FAKULTETI I ARKITEKTURËS DHE URBANISTIKËS


NR.	PYETJA	VLERËSIMI	EVOLUIMI NË RAPORT ME ANKETIMIN E MËP.
P1	Informon në fillim të semestrit për përmbajtjen, objektivat dhe detyrimet e programit mësimor.	4.759	▲
P2	Respekton vazhdimisht dhe me përpikmëri orarin mësimor.	4.677	▲
P3	Eshtë lehtësisht i kuptueshëm gjatë referimit / komunikimit në procesin mësimor.	4.644	▲
P4	Sqaron aspektet teorike me shembuj praktike dhe/ose ilustrime të qarta.	4.701	▲
P5	Përdor në mënyrë efektive mjete ndihmëse në procesin mësimor (dërrasën e zezë, video projektorin, etj), sipas specifikës dhe natyrës së lëndës.	4.728	▲
P6	Rekomandon literaturë ndihmëse në lidhje me procesin mësimor.	4.676	▲
P7	Komunikon dhe sillet brenda kuadrit etik.	4.801	▲
P8	Eshtë i gatshëm të ndihmojë studentët edhe përtej orës së mësimi.	4.617	▲
P9	Nxit interesin dhe motivon studentët në lëndën përkatëse.	4.627	▲
FR	Formula e Rankimit	4.691	▲
N	Nota (Mes. e UPT 9.220)	9.212	▲
NUMRI I ANKETIMEVE		2321	▲



Nr.	Programi i Studimit	P1	P2	P3	P4	P5	P6	P7	P8	P9	Formula e Rankimit	Nota mes.	Nr. Anketimeve
1	Bachelor në "Arkitekturë Interieri dhe Dizajn"	4.730	4.665	4.589	4.665	4.695	4.619	4.754	4.592	4.584	4.653	9.078	370
2	Master i Shkencave në "Arkitekturë" me profil "Arkitekt"	4.775	4.673	4.648	4.708	4.730	4.680	4.805	4.597	4.607	4.691	9.270	1224
3	Master i Shkencave në "Arkitekturë" me profil "Urbanist"	4.747	4.691	4.666	4.708	4.741	4.699	4.820	4.664	4.684	4.713	9.183	727

● FAKULTETI I GJEOLGJISË DHE I MINIERAVE


NR.	PYETJA	VLERËSIMI	EVOLUIMI NË RAPORT ME ANKETIMIN E MËP.
P1	Informon në fillim të semestrit për përmbajtjen, objektivat dhe detyrimet e programit mësimor.	4.748	▼
P2	Respekton vazhdimisht dhe me përpikmëri orarin mësimor.	4.749	▼
P3	Është lehtësisht i kuptueshëm gjatë referimit / komunikimit në procesin mësimor.	4.678	▼
P4	Sqaron aspektet teorike me shembuj praktike dhe/ose ilustrime të qarta.	4.715	▼
P5	Përdor në mënyrë efektive mjete ndihmëse në procesin mësimor (dërrasën e zezë, video projektorin, etj), sipas specifikës dhe natyrës së lëndës.	4.754	▼
P6	Rekomandon literaturë ndihmëse në lidhje me procesin mësimor.	4.634	▼
P7	Komunikon dhe sillet brenda kuadrit etik.	4.782	▼
P8	Është i gatshëm të ndihmojë studentët edhe përtej orës së mësimi.	4.656	▼
P9	Nxit interesin dhe motivon studentët në lëndën përkatëse.	4.668	▼
FR	Formula e Rankimit	4.714	▼
N	Nota (Mes. e UPT 9.220)	9.147	▼
NUMRI I ANKETIMEVE		614	▲



Nr.	Programi i Studimit	P1	P2	P3	P4	P5	P6	P7	P8	P9	Formula e Rankimit	Nota mes.	Nr. Anketimeve
1	Bachelor në "Inxhinieri e Naftës dhe Gazit"	4.794	4.776	4.804	4.832	4.832	4.794	4.822	4.804	4.804	4.804	9.393	107
2	Bachelor në "Inxhinieri Gjeoinformatike"	4.664	4.622	4.471	4.538	4.605	4.403	4.706	4.429	4.437	4.550	8.916	119
3	Master i Shkencave në "Inxhinieri Gjeologjike" me profil "Gjeoinformatikë"	4.805	4.766	4.727	4.753	4.779	4.714	4.857	4.688	4.740	4.763	9.506	77
4	Master i Shkencave në "Inxhinieri Gjeologjike" me profil "Gjeologji Inxhinierike dhe Hidrogeologji"	4.661	4.804	4.643	4.714	4.839	4.625	4.768	4.661	4.679	4.721	8.982	56
5	Master Profesional në "Inxhinierinë e Burimeve Minerare" me profil "Gjeomatikë"	4.808	4.832	4.768	4.792	4.808	4.688	4.816	4.744	4.712	4.780	9.200	125

● FAKULTETI I INXHINIERISË ELEKTRIKE


NR.	PYETJA	VLERËSIMI	EVOLUIMI NË RAPORT ME ANKETIMIN E MËP.
P1	Informon në fillim të semestrit për përmbajtjen, objektivat dhe detyrimet e programit mësimor.	4.781	▲
P2	Respekton vazhdimisht dhe me përpikmëri orarin mësimor.	4.760	▲
P3	Eshtë lehtësisht i kuptueshëm gjatë referimit / komunikimit në procesin mësimor.	4.690	▲
P4	Sqaron aspektet teorike me shembuj praktike dhe/ose ilustrime të qarta.	4.754	▲
P5	Përdor në mënyrë efektive mjete ndihmëse në procesin mësimor (dërrasën e zezë, video projektorin, etj), sipas specifikës dhe natyrës së lëndës.	4.740	▲
P6	Rekomandon literaturë ndihmëse në lidhje me procesin mësimor.	4.660	▲
P7	Komunikon dhe sillet brenda kuadrit etik.	4.825	▲
P8	Eshtë i gatshëm të ndihmojë studentët edhe përtej orës së mësimi.	4.678	▲
P9	Nxit interesin dhe motivon studentët në lëndën përkatëse.	4.681	▲
FR	Formula e Rankimit	4.732	▲
N	Nota (Mes. e UPT 9.220)	9.328	▲
	NUMRI I ANKETIMEVE	2207	▲



Nr.	Programi i Studimit	P1	P2	P3	P4	P5	P6	P7	P8	P9	Formula e Rankimit	Nota mes.	Nr. Anketimeve
1	Bachelor në "Inxhinieri Elektrike", me profil "Energjitikë"	4.793	4.792	4.721	4.781	4.779	4.703	4.826	4.709	4.727	4.762	9.441	1100
2	Bachelor në "Inxhinieri Mekanike"	4.780	4.744	4.653	4.692	4.705	4.599	4.815	4.653	4.613	4.700	9.166	519
3	Master profesional në "Inxhinieri Elektrike" me profil "Automatizim Industri"	4.755	4.736	4.653	4.753	4.672	4.607	4.819	4.620	4.635	4.698	9.221	458

● FAKULTETI I INXHINIERISË MATEMATIKE DHE INXHINIERISË FIZIKËS


NR.	PYETJA	VLERËSIMI	EVOLUIMI NË RAPORT ME ANKETIMIN E MËP.
P1	Informon në fillim të semestrit për përmbajtjen, objektivat dhe detyrimet e programit mësimor.	4.828	▲
P2	Respekton vazhdimisht dhe me përpikmëri orarin mësimor.	4.805	▲
P3	Eshtë lehtësisht i kuptueshëm gjatë referimit / komunikimit në procesin mësimor.	4.745	▲
P4	Sqaron aspektet teorike me shembuj praktike dhe/ose ilustrime të qarta.	4.772	▼
P5	Përdor në mënyrë efikase mjete ndihmëse në procesin mësimor (dërrasën e zezë, video projektorin, etj), sipas specifikës dhe natyrës së lëndës.	4.805	▲
P6	Rekomandon literaturë ndihmëse në lidhje me procesin mësimor.	4.738	▲
P7	Komunikon dhe sillet brenda kuadrit etik.	4.854	▲
P8	Eshtë i gatshëm të ndihmojë studentët edhe përtej orës së mësimi.	4.762	▲
P9	Nxit interesin dhe motivon studentët në lëndën përkatëse.	4.739	▲
FR	Formula e Rankimit	4.784	▲
N	Nota (Mes. e UPT 9.220)	9.519	▲
NUMRI I ANKETIMEVE		522	▲



Nr.	Programi i Studimit	P1	P2	P3	P4	P5	P6	P7	P8	P9	Formula e Rankimit	Nota mes.	Nr. Anketimeve
1	Bachelor në "Inxhinieri Kimike"	4.939	4.896	4.757	4.870	4.896	4.704	4.913	4.826	4.696	4.829	9.643	115
2	Bachelor në "Inxhinierinë Fizike"	4.920	4.880	4.900	4.860	4.880	4.880	4.940	4.880	4.900	4.896	9.820	50
3	Bachelor në "Inxhinierinë Matematike"	4.800	4.691	4.636	4.600	4.745	4.582	4.873	4.782	4.655	4.704	9.273	55
4	Master i Shkencave në "Inxhinieri Fizike" me profil "Inxhinier Fizike"	4.717	4.717	4.707	4.727	4.727	4.737	4.758	4.707	4.707	4.723	9.636	99
5	Master i Shkencave në "Inxhinieri Fizike" me profile "Fizikan Mjekësor"	4.860	4.879	4.850	4.841	4.832	4.841	4.907	4.776	4.860	4.859	9.626	107
6	Master i Shkencave në "Inxhinieri Matematike"	4.604	4.585	4.585	4.585	4.642	4.566	4.660	4.642	4.604	4.606	8.906	53

● FAKULTETI I INXHINIERISË SË NDËRTIMIT


NR.	PYETJA	VLERËSIMI	EVOLUIMI NË RAPORT ME ANKETIMIN E MËP.
P1	Informon në fillim të semestrit për përmbajtjen, objektivat dhe detyrimet e programit mësimor.	4.717	▲
P2	Respekton vazhdimisht dhe me përpikmëri orarin mësimor.	4.659	▲
